

Remziun dy herë e arrestuan dhe e dënuan për shkak të veprimtarisë së tij politike. Nga viti 1992 deri në vitin 1995, e udhëhiqte degën prizrenase të organizatës humanitare *Nëna Terezë/Majka Tereza*, si dhe zyrën e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDDLNJ). Pas lirimit nga burgu në vitin 1998, e emëruan komandant brigade të UÇK-së *Vërrini*. Ishte, po ashtu, edhe zëvendës komandant i zonës operative të UÇK-së *Pashtrik/Paštrik*. Në datën **15.08.1998**, nga ora 22:30, Remziu po kthehej nga takimi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, që ishte mbajtur në Kleçkë/Klečka. Në makinë me të ishte edhe Xhevat Berisha. Në fshatin **Grazhdanik/Graždanik**, ata hasën në postbllokun e policisë serbe. Në thirrjen e policisë serbe që të ndaleshin me makinë, Xhevati dhe Remziu reaguan duke hapur zjarr. Policët serb u kundërpërgjigjën me zjarr. Remziu ka gjetur vdekjen në këtë përleshje të armatosur, ndërkaq Xhevati ka arritur të shpëtonte. Në anën tjetër, dy policë serb u plagosën. Remziun e kanë varrosur më 16.08.1998 në varrezat e Lubeqevës/Ljubiçevo. Pas lufte, më 15.09.1999, mbetjet e tij mortore u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës, në Landovicë/Landovica.

**Burimet:** deklarata E.A, FDH-20868; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHFДУÇK, *Feniksët...2*, 219-222; SHFДУÇK, *Feniksët...3*, 151-154; SMIP, *Teroristički...*, III, 460.

### **Hazir (Hysen) Selimaj**

(28.08.1954, shqiptar nga Grejkoci/Grejkovce, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

### **Zenel (Hasan) Curraj**

(24.06.1973, shqiptar nga Grejkoci/Grejkovce, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor ndërtime, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

### **Sabit (Rifat) Lushaj**

(7.04.1975, shqiptar nga Grejkoci/Grejkovce, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, i martuar, pjesëtar i UÇK-së)

### **Naser (Rizah) Tafaj**

(1.11.1975, shqiptar nga Grejkoci/Grejkovce, komuna e Suharekës/Suva Reka, murator, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

### **Fadil (Muhamed) Balaj**

(28.12.1977, shqiptar nga Korisha/Koriša, komuna e Prizrenit/Prizren, punëtor, i martuar, pjesëtar i UÇK-së)

Në datën 5.08.1998, Zeneli, Sabiti dhe Naseri me një grup të rinjve nga fshati u nisën për në Shqipëri për një ngarkesë armatimesh. Në Shqipëri u pritën nga Haziri dhe një mik i tyre nga Grejkoci/Grejkovce, që u ndihmuan që të blinin armatime. Në datën 17.08.1998, Haziri, Zeneli, Sabiti dhe Naseri me një grup burrash, në mesin e të cilëve ishte edhe Fadili, i cili kishte shkuar në Shqipëri pesë ditë më herët për tu furnizuar me armatime, u nisën për në Kosovë. Diku nga mesnata, në afërsi të postbllokut ushtarak [Gorozhup/Gorožup] në bjeshkën e *Pashtrikut/Paštrik*, i tërë grupi ka rënë në pusi të pjesëtarëve të UJ-së. Në shkëmbimin e zjarrit dhe nga eksplozimet e granatave, Zeneli, Haziri, Sabiti dhe Fadili kanë gjetur vdekjen në vend, ndërkaq Naseri u plagos rëndë. Ai arriti që të largohej nga vendi i konfliktit në drejtim të Lubizhdës së Hasit/Ljubižda Has, por ndërroi jetë te vendi i quajtur *Liçeni i Grave/Žensko jezero*, që gjendet mes Lubizhdës së Hasit/Ljubižda Has dhe Gorozhupit/Gorožup. Pjesëtarët e UJ-së i kanë bartur trupat e Fadilit, Zenelit, Hazirit dhe Sabitit në morgun e Prizrenit/Prizren. Në datën 19.08.1998, familjet i kanë marrë trupat e Zenelit, Haziri dhe Sabitit dhe i kanë varrosur në varrezat në Grejkoc/Grejkovce, ndërkaq Fadili u varros në varrezat e Korishës/Koriša. Trupi i Naserit ishte zbuluar një muaj më vonë. Familjarët e kanë varrosur më 21.09.1998 në varrezat e Grejkocit/Grejkovce. Pas lufte, më 15.09.1999, mbetjet mortore të Fadilit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Landovicë/Landovica. Mbetjet mortore të Zenelit, Hazirit, Sabitit dhe Naserit u rivarrosën më 18.09.1999 në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës, në Suharekë/Suva Reka.

**Burimet:** deklarata R.T, FDH-34788; deklarata Xh.C, FDH-34779; deklarata T.B, FDH-8915; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.D 300.82, FDH-30600; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.P.241B, FDH-5838; *Serb Forces Shell Rahovec and Suhareka Villages*, pasqyra e lajmeve, KIC, 20.08.1998, FDH-29444; fotografi, FDH-20988;